




REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY		REPUBLIC OF KOSOVO	
Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.	01-3109/13
Dep.		Pro. No.	
Nr. i flet.	03	Data	01.10.2013
Broj stranica		Dr. imi	
Nr. pages		Dr. mbi	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	01/10/2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Ekrem MALIQI u.d. Drejtor i Prokurimit, Ministria e Shëndetësisë
CC:	z. Gani SHABANI u.d. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për Tenderin "Furnizim me barna, material medicinal, material stomatologjik dhe pajisje medicinale"

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin "Furnizim me barna, material medicinal, material stomatologjik dhe pajisje medicinale", me nr. të prokurimit: 206-13-086-121, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Furnizim me barna, material medicinal, material stomatologjik dhe pajisje medicinale" me nr. të prokurimit: 206-13-086-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 - L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Zyra e Prokurimit nga Ministria e Shëndetësisë më datë 04/09/2013 ka përgatitë “Njoftim Kontrate” me titullin: “Furnizim me barna, material medicinal, material stomatologjik dhe pajisje medicinale” me nr. prokurimi: 206-13-086-121, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-ës më datë 05/09/2013 si Kontratë Publike Kornizë 24 Mujore. Më datën 17/09/2013 është vendosur sërish me “Shtyrja e Afatit”, ku në KRPP është ri shpallur me datë 18/09/2013, me emërtim dhe me numër të njëjtë prokurimi.

Në “Njoftim Kontrate” të publikuar në KRPP më datë 05/09/2013, tek pika III.2.4 e rubrikës “Kapaciteti Teknik dhe Profesional”, në paragrafin e parë thuhet se: Emri i prodhuesit dhe vendi. Produktet duhet të jenë prodhime të shteteve të Bashkimit Evropian - vendet e zonës Shengen, si dhe shtetet: Zvicër, SHBA, Kanada, Britani e Madhe, Australi, Zelandë e Re, Japoni dhe Izrael.

Në publikimin tjetër “Shtyrja e Afatit” për të njëjtin prokurim në KRPP të datës 18/09/2013, tek pika III.2.4 e rubrikës “Kapaciteti Teknik dhe Profesional”, në paragrafin e parë thuhet se: Produktet duhet të jenë të prodhuara ose të regjistruara në shtetet e Bashkimit Evropian - vendet e zonës Shengen, si dhe shtetet: Zvicër, SHBA, Kanada, Britani e Madhe, Australi, Zelandë e Re, Japoni dhe Izrael.

Në formulimin e të dy publikimeve është cekur origjina e produktit. Me përcaktimin e vendit të origjinës për produktet favorizohet ndonjë OE dhe në të njëjtën kohë diskriminohet ndonjë tjetër. Autoriteti Kontraktues mund të i referohet një standardi vendor ose ndërkombëtar, por assesi të kërkohej nga ndonjë vend specifik. Bazuar në legjislacionin e vendit dhe ligjeve në fuqi, një gjë e tillë nuk është e lejuar dhe nuk i jep hapësirë konkurrencës së lirë dhe legale.

Në udhëzimin Administrativ të MSH, me numër Nr.04/2008 (Procedura e thjeshtësuar për autorizim marketingu për vendet e BE-së (shengen), SHBA, Kanadë, Zvicër, Izrael dhe Japoni) thuhet: Të drejtën e aplikimit sipas kësaj procedure e kanë vetëm personat juridik që aplikojnë për produkte medicinale të cilat janë të regjistruar në vendet e BE-së (Shengen), SHBA, Kanadë, Zvicër, Izrael dhe Japoni, nuk i përshtatet kësaj forme të prokurimit, pasi që të gjitha produktet e regjistruara më parë nga AKPM mund të futen në Kosovë, edhe nëse nuk janë nga vendet e lartë cekura, e të cilët mund të marrin autorizim marketingu nga AKPM (pa procedurë të thjeshtuar). Ky veprim edhe më shumë e shton argumentin tonë kur në “Dosja e Tenderit” janë përfshi edhe dy vende tjera (Zelanda e Re dhe Australia) të cilat nuk janë potencuar as në udhëzimin administrativ (Nr.04/2008).

Autoriteti Kontraktues (DP-MSH) në përgjigjet e dhëna për OE që kishin kërkuar sqarime në lidhje me disa detaje procedurale, në përgjigjen nr.3 që u është lëshuar OE përmes emailit më datë 17/09/2013, thuhet: “Duke marrë parasysh se ky tender përfshinë një numër të madh të barnave të futur në një LOT, për Operatorët Ekonomik është bërë lehtësim në kritere, ku nuk është kërkuar që barnat të jenë të regjistruara në AKPM” Ky veprim bie ndesh me: Neni 28, paragrafi 2 (Qarkullimi dhe vënia në shërbim e pajisjeve medicinale) të ligjit “Për Produkte dhe Pajisje Medicinale” Nr. 03/L-188, ku thuhet: “Para se pajisjet medicinale të vendosen në treg dhe të vihen në përdorim në Kosovë, prodhuesi apo furnizuesi i tyre dorëzon në AKPM dosjen për regjistrim...” Mos respektimi i këtij ligji, u jep mundësi produkteve medicinale të kontrabanduara të futen në përdorim. Një veprim i tillë dëmton tregun legat dhe rrezikon shëndetin e përdoruesve.

Gjatë përpunimit të dokumentacionit të ofruar nga "Ministria e Shëndetësisë, AKK ka gjetur mos përputhje në mes të "Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve" të datës 02/09/2013 dhe "Dosja e Tenderit". Në "Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve" është nxjerrë si numër i Prokurimit 206-13-040-121, ndërsa në "Dosja e Tenderit" dhe "Njoftim për Kontratë" nr i prokurimit është 206-13-086-121.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë që bien ndesh me Nenin 7, Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi; dhe nenin 27 Dosja e Tenderit.

Konsiderojmë se një shkelje e tillë, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Me respekt!

